



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 06/L -142

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA AG
NË LIDHJE ME FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR NDËRTIMIN E
SISTEMIT TË KANALIZIMIT PËR KOMUNËN E SHTIMES**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË
NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE UNICREDIT BANK
AUSTRIA AG NË LIDHJE ME FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR
NDËRTIMIN E SISTEMIT TË KANALIZIMIT PËR KOMUNËN E
SHTIMES**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim që të ratifikojë marrëveshjen për kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për projektin për ndërtimin e sistemit të kanalizimit për komunën e Shtimes.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Nëpërmjet këtij ligji ratifikohet Marrëveshja për kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për projektin për ndërtimin e sistemit të kanalizimit për komunën e Shtimes.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Në Shtojcën e këtij ligji është e bashkëngjitur Marrëveshja për kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për projektin ndërtimin e sistemit të kanalizimit për komunën e Shtimes.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L -142
30 janar 2019

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI